

Hidromorava
Gjilan
KOMPANIA RAJONALE
E UJËSJELLËSIT
HIDROMORAVA Sh.a.
No. 1193 Data 27.08.2025
GJILAN



RAPORT I PUNËS

PËR TREMUJORIN
E DYTË TË VITIT

2025

KRM
HIDROMORAVA

TABELA E PËRMBAJTJES

1. KRYESHEFI EKZEKUTIV	6
1.1. Hyrje	6
1.2. Aktivitetet kryesore	7
1.3. Vendime dhe akte të tjera	10
2.1. Vendimet e Bordit të Drejtorëve	13
3. KOMISIONI I AUDITIMIT	14
3.1. Vendimet e Komisionit të Auditimit	14
4. ZYRA E SEKRETARES/DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV	15
4.1. Struktura e të punësuarve	15
4.2. Çështjet gjyqësore	15
5. DEPARTAMENTI FINANCIAR	18
5.2. Shqyrtimi performancës operative dhe financiare	18
5.2.1. Prodhimi i ujit në m ³	18
5.2.2. Faturimi i ujit në m ³	18
5.2.3. Faturimi i ujit në euro (€)	19
5.2.4. Arkëtimi i ujit	19
5.2.5. Përqindja e arkëtimit	20
5.2.6. Shpenzimet	20
5.3. Shpalosje e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare me 30 qershor 2025	31
6. ZYRA E PROKURIMIT	38
7. DIVIZIONI PËR CILËSI TË UJIT	40
7.1. Cilësia e ujit	40
8. DIVIZIONI PËR PRODHIMIN, IMPIANTET E UJIT DHE STACIONET E POMPIMIT	43
8.1. Furnizimi me ujë	43
8.1.1. Pajisje teknike dhe procedura të tenderimit	43
8.1.2. Mirëmbajtja e infrastrukturës	43
8.1.3. Implementimi i projektit FLOWS	43
8.2. Sasia e ujit të prodhuar, ujit të faturuar dhe humbjeve të ujit	44
8.3. Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit	45
8.3.1. DMA - zonat	48
8.4. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit	49
9. DIVIZIONI PËR PLANIFIKIM DHE MENAXHIM TË PROJEKTEVE	50
9.1. Aktivitetet e realizuara gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025	50

TABELAT

Tabela 1. Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet dhe organizatat relevante gjatë periudhës TM2/2025	7
Tabela 2. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM2/2025	10
Tabela 3. Numri i të punësuarve në njësitë punuese gjatë periudhës së TM2/2025	15
Tabela 4. Struktura gjinore e të punësuarve gjatë periudhës së TM2/2025	15
Tabela 5. Lëndët e pranuar nga Gjykatat kompetente gjatë periudhës së TM2/2025	15
Tabela 6. Paraqitja grafike e prodhimit të ujit në m ³	18
Tabela 7. Paraqitja grafike e faturimit të ujit në m ³	19
Tabela 8. Paraqitja grafike e faturimit në euro (€)	19
Tabela 9. Paraqitja grafike e arkëtimit të ujit	20
Tabela 10. Paraqitja grafike e përqindjes së arkëtimit	20
Tabela 11. Paraqitja grafike e shpenzimeve në €	21
Tabela 12. Raporti i performancës operative dhe financiare për region TM2/2025 dhe TM2/2024 dhe plani TM2/2025 ..	22
Tabela 13. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë e Gjiçanit TM2/2025 dhe krahasimi me TM2/2024	23
Tabela 14. Raporti i performancës operative dhe financiar për Njësinë e Kamenicës TM2/2025 dhe krahasimi me TM2/2024	24
Tabela 15. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë e Vitisë për TM2/2025, krahasimi me TM2/2024	25
Tabela 16. Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë në banka dhe në arkë	31
Tabela 17. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera	32
Tabela 18. Stoket	32
Tabela 19. Pasuritë tjera afatshkurta	33
Tabela 20. Pronat, impiantet dhe pajisjet	33
Tabela 21. Llogaritë e pagueshme	34
Tabela 22. Detyrimet afatshkurtra	35
Tabela 23. Të hyrat e shtyra/grantet	35
Tabela 24. Ekuiteti	35
Tabela 25. Të hyrat	35
Tabela 26. Shpenzimet e shpërndarjes	36
Tabela 27. Shpenzime administrative tjera	36
Tabela 28. Fitimi (humbja) para tatimit	36
Tabela 29. Ndryshimet në ekuitet	37
Tabela 30. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM2/2025 – vlerë minimale	38
Tabela 31. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM2/2025 – kuotim i çmimit	38
Tabela 32. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM2/2025 – procedurë e hapur – vlerë e mesme	38
Tabela 33. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM2/2025 – "Aneks kontratë"	39
Tabela 34. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM2/2025	44
Tabela 35. Zona e shërbimit, numri dhe natyra e defekteve të ndodhura gjatë periudhës së TM2/2025	45
Tabela 36. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë periudhës së TM2/2025 në DMA zonat për regjionin e Gjiçanit	48

Tabela 37. Numri i intervenimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së TM2/2025. 49	Tabela 38. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit gjatë periudhës së TM2/2025 në Gjiilan 49
Tabela 39. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë periudhës së TM2/2025 50	

SHËNIMET SHPJEGUESE

Shënimet shpjeguese 1. Paraja dhe ekuivalentët e parasë 31	
Shënimet shpjeguese 2. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat e tjera 32	Tabela 17. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat
Shënimet shpjeguese 3. Stoqet 32	
Shënimet shpjeguese 4. Pasuritë tjera afatshkurta 33	
Shënimet shpjeguese 5. Pasuritë afatgjata - Pronat, impiantet dhe pajisjet 33	
Shënimet shpjeguese 6. Investimet në vijim/projektet 33	
Shënimet shpjeguese 7. Llogaritë e pagueshme për TM2/2025 34	
Shënimet shpjeguese 8. Detyrimet afatshkurtra 34	
Shënimet shpjeguese 9. Të hyrat e shtyera/grantet 35	
Shënimet shpjeguese 10. Ekuiteti 35	
Shënimet shpjeguese 11. Të hyrat 35	
Shënimet shpjeguese 12. Shpenzimet e shpërndarjes 36	
Shënimet shpjeguese 13, 14, 15, 16, 17. Administrative dhe tjera 36	
Shënimet shpjeguese 18 - Fitimi(humbja) para tatimit e vitit 36	
Shënimet shpjeguese 19 - Fitimi/humbja e vitit - shpalosje në shënimin nr.18..... 37	
Shënimet shpjeguese 20 - Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve - shpalosje në shënimin nr.5. 37	
Shënimet shpjeguese 21 - Rritje/zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme - shpalosje shënimi nr.2. 37	
Shënimet shpjeguese 22 - Rritje/zvogëlim në stoqe - shpalosje shënimi nr.3..... 37	
Shënimet shpjeguese 23 - Rritje/zvogëlim në llogaritë e pagueshme tregtare - shpalosje shënimi nr.7 37	
Shënimet shpjeguese 24 - Rritje/zvogëlim në detyrimet e tjera - shpalosje në shënimin nr. 8 37	

FJALORI I AKRONIMEVE/SHKURTESAVE

ARRU	Autoriteti Rregullator i Ujërave
B.I.	Biznes Individual
DMA Zona	District Metered Area (Zona e Matjes së Rrjetit/Ujësjes)
EBRD	European Bank for Reconstruction and Development (shqip: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim)
FLAWS	Fostering and Leveraging Opportunities for Water Security (shqip: Nxitja dhe Shfrytëzimi i Mundësive për Sigurinë Ujore)
FPU	Fabrika e Përpunimit të Ujit
GIS	Geographic Information System (Sistemi Gjeografik i Informacionit)
HM	Hidromorava
IKSHIP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
IMF	Institucionet mikrofinanciare
ITUN	Impianti i trajtimit të ujërave të ndotur
KESCO	Kompania për shpërndarjen e Energjisë Elektrike të Kosovës
KIWER	Kosovar Institute for Water and Environmental Research (Instituti Kosovar për Kërkime në Fushën e Ujit dhe Mjedisit)
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjes
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NTSh	Ndërmarrje Tregtare Shoqërore
Nj.O.	Njësi Operative e KRU Hidromorava Sh.A.
Sh.A.	Shoqëri Aksionare
ShPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SHUKOS	Shoqata e Ujësjes dhe Kanalizimeve të Kosovës
SHUKALB	Shoqata e Ujësjes dhe Kanalizimeve të Shqipërisë
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
UPF	Uji i pafaturuar

FJALORI I TERMAVE TEKNIK TË PËRDORUR

Gypat AC	Gypat prej azbest/cementi
Gypat HDPE	Gypat prej polietileni të fortë dhe të qëndrueshëm
Gypat DN 80 mm	Gypat me diametër nominal 80 milimetra
Gypat PE	Gypat prej polietileni

1. KRYESHEFI EKZEKUTIV

1.1. Hyrje

Raporti i përket periudhës raportuese të tremujorit të dytë të vitit 2025 dhe ndërlidhet me performancën aktuale financiare dhe operative, përshkrimin e arritjeve të caqeve të planit të biznesit të KRU "Hidromorava" – Sh.A. Gjilan. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025, Ndërmarrja ka vazhduar të përballet me një sërë sfidash të natyrës teknike, operative dhe financiare, të cilat kanë ndikuar në menaxhimin efikas të resurseve dhe realizimin e objektivave strategjike. Një ndër sfidat më të theksuara gjatë periudhës së tremujorit të dytë kanë qenë funksionimi i sistemit të komunikimit në distancë ndërmjet pompave dhe fabrikës, i cili, për shkak të problemeve me kartelat teknike, ka qenë i pamundur për një periudhë të konsiderueshme. Kjo ka bërë që gjatë natës, për shkak të kushteve të pasigurta në terren, prodhimi të mos menaxhohet në mënyrë optimale, duke ndikuar në rritjen e humbjeve të ujit. Pas rregullimit të kartelave në fund të muajit prill, situata është përmirësuar ndjeshëm, duke mundësuar menaxhim më të saktë dhe ulje të prodhimit të panevojshëm gjatë natës.

Gjatë kësaj periudhe, sfidë e vazhdueshme ka qenë edhe *inkasimi i borxheve të vjetra*, sidomos nga konsumatorët që nuk kanë paguar për një kohë të gjatë. Vështirësitë në arkëtim ndikojnë drejtpërdrejt në likuiditetin financiar dhe kufizojnë investimet për mirëmbajtje dhe zhvillim të mëtejshëm të infrastrukturës. Për më tepër, baza ligjore aktuale lejon parashkrimin e borxheve më të vjetra se një vit, çka e vështirëson më tej procesin e arkëtimit.

Ndër sfidat financiare, vlen të përmendet *mungesa e fondeve për përmbylljen e projektit ITUZ – Gjilan*, për shkak të mospërputhjes së buxhetit të miratuar në vitin 2019 me çmimet aktuale të tregut, të rritura si pasojë e inflacionit. Megjithatë, Ministria e Ekonomisë ka konfirmuar përfshirjen e kërkesës për fonde shtesë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2026–2028, dhe pritet aprovimi përfundimtar nga EBRD.

Gjithashtu, sfidë serioze paraqet *mbulimi i TVSH-së për kredinë nga Banka Evropiane për Investime*, në vlerë totale prej 11 milionë euro. TVSH-ja për periudhën 2025–2027 llogaritet të arrijë 2 milionë euro – një barrë e rëndë për buxhetin e Ndërmarrjes. Në këtë drejtim, është zhvilluar takim me zyrtarët e ATK-së për të shqyrtuar mundësinë e kthimit të përsheptuar të TVSH-së së investimeve kapitale.

Një sfidë tjetër që kërkon koordinim të lartë është *menaxhimi paralel i projekteve të shumta*, përfshirë projektet të financuara nga të hyrat e vet Ndërmarrjes, projektet me Ministrinë e Ekonomisë, si dhe ato në bashkëpunim me Bankën Botërore (projekti FLOWS) dhe me EBRD për projektin ITUZ. Projekti FLOWS është në fazën e zbatimit në terren, ndërsa projekti me EBRD ka hyrë në fazën përfundimtare të vlerësimit të ofertave.

Po ashtu, gjatë muajit qershor, në disa lagje të vendosura në lartësi më të mëdha, janë paraqitur vështirësi të përkohshme në furnizim me ujë për shkak të konsumit të lartë gjatë periudhës së temperaturave ekstreme, ndërsa në pjesët tjera të qytetit furnizimi ka qenë stabil.

Përkundër të gjitha sfidave të lartpërmendura, Ndërmarrja mbetet e përkushtuar në zbatimin e masave konkrete për përmirësimin e funksionimit operativ, menaxhimin e resurseve dhe garantimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me ujë për të gjithë konsumatorët.

Ndërmarrja ka vepruar sipas Planit të Veprimit dhe ka ndërmarrë hapa konkretë për adresimin e këtyre çështjeve, përfshirë edhe angazhimin me institucionet relevante për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme. Në vijim paraqiten sfidat kryesore gjatë kësaj periudhe.

1.2. Aktivitetet kryesore

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, krahas angazhimeve të përditshme në menaxhim të Ndërmarrjes, Kryeshefi Ekzekutiv ka mbajtur edhe takimet e listuara në tabelën më poshtë:

Tabela 1. Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet dhe organizatat relevante gjatë periudhës TM2/2025

Nr.	Institucioni:	Data:	Qëllimi i takimit:
1.	Komuna Viti	01.04.2025	Takim pune me Kryetarin e Komunës në Viti, ku si temë diskutimi ka qenë marrja nën menaxhim të ujësjellësit në fshatin Zhiti si dhe mbështetja me ekspert të Kompanisë tonë për finalizimin e projektit të ujësjellësit për fshatin Beguncë.
2.	Banka Botërore	02.04.2025	Takim pune me përfaqësuesit e Bankës Botërore, ku është bërë prezantimi i dizajnit preliminar për Digën në Kremënatë, Komuna e Kamenicës.
3.	SHUKALB - SHUKOS	03&04.04.2025	Takim pune i Bordit SHUKALB dhe Bordit SHUKOS në Korçë, me ç'rast si temë kryesore e diskutimit ka qenë organizimi i Konferencës së përbashkët vjetore, e cila këtë vit do të mbahet në Shqipëri.
4.	Komuna Gjilan	15.04.2025	Takim pune me Kryetarin e Komunës Gjilan, me ç'rast si temë diskutimi ka qenë bashkërendimi i aktiviteteve në projektet e përbashkëta si dhe lejet e punës nga Komuna për t'i realizuar investimet e planifikuara sipas procesit tarifor.
5.	SHUKOS	15&16.03.2025	Punëtori e organizuar në kuadër të SHUKOS në Hotel Brezovica, ku si temë kryesore në këtë punëtori ka qenë prezantimi i PSU-ve (Planeve të Sigurisë së Ujit) nga të gjitha KRU-të, pasi që është obligim ligjor që secila KRU deri në fund të vitit duhet ta këtë të finalizuar dhe të miratuar nga Bordi këtë plan.
6.	SHUKOS	29.04.2025	Takimi i tretë i rregullt i Bordit SHUKOS, ku përveç pikave të rregullta, me theks të veçantë është diskutuar edhe për obligimin e kalimit në tregun e hapur për furnizim me energji elektrike, e që pritet të këtë ndikim në rritjen e shpenzimeve të energjisë elektrike në të gjitha KRU-t.
7.	Ministria e Ekonomisë	05.05.2025	Takim pune në të cilin kanë marrë pjesë të gjitha Ndërmarrjet Publike të cilat kanë mbi 50 punëtor. Si temë kryesore ka qenë liberalizimi i tregut të energjisë dhe kalimi i obliguar i Ndërmarrjeve Publike në tregun e lirë të furnizimit me energji.

8.	SHUKOS	05.05.2025	Takim pune në SHUKOS, ku si pikë kryesore ka qenë diskutimi për kalimin e obliguar të KRU-ve në tregun e lirë të furnizimit me energji, me ç'rast është marrë vendim që të gjitha KRU-të të aplikojnë së bashku përmes SHUKOS.
9.	Komuna Gjilan	15.05.2025	Është diskutuar për punimet që janë duke u zhvilluar edhe nga Komuna e Gjilanit edhe nga KRU Hidromorava, në mënyrë që ti bashkërendojnë aktivitetet e punimeve nëpër rrugët e qytetit.
10.	EBRD	15.05.2025	Takim pune me përfaqësuesit e EBRD, ku kemi diskutuar për zhvillimet e fundit për ITUN. Përfaqësuesit e EBRD janë njoftuar se Ministria e Ekonomisë e ka futur në KASH vlerën prej 5,000,000.00€, si dhe Komuna Gjilan e ka dërguar shkresën zyrtare që ka ndarë mjetet për shpronësim të kolektorëve dhe kemi kërkuar që sa më shpejtë të nënshkruhen marrëveshjet me Operatorin Ekonomik për mbikëqyrje dhe për ndërtimin e kolektorëve.
11.	FLAWS	19.05.2025	Takim me përfaqësuesit e FLAWS, ku si temë kryesore ka qenë diskutimi për progresin e punimeve në terren. Në takim kanë marr pjesë edhe përfaqësuesit e Kompanisë mbikëqyrëse të punimeve si dhe përfaqësuesit e Kompanisë punë kryerëse.
12.	KIWER	21.05.2025	Takim pune me përfaqësuesit e grupit të ekspertëve nga KIWER, me ç'rast kemi diskutuar për fazën e parë të investimeve të shpejta të cilat mund të kapin vlerën deri në 100,000.00€. Nga KRU Hidromorava janë propozuar disa projekte për investime siç janë : Riaktivizimi i DMA zonave, instalimi i ujëmatësve me dataloger për institucione dhe qendra të mëdha, instalimi i pompave eficiente, zëvendësimi i ujëmatësve me të vjetër se 10 vite, zhvillimi i pajisjes për lexim të ujëmatësve të konsumatorëve në kohë reale etj.
13.	SHUKOS	22&23.05.2025	Punëtori në Durrës e organizuar nga SHUKOS, ku si detyrë kryesore ka qenë rishikimi i statusit të shoqatës, ku kanë marr pjesë të gjithë KE-të e KRU-ve, përfaqësuesit e SHUKOS, përfaqësuesit ME-së, si dhe KE i NP "Ibër Lepenc".
14.	Komuna Viti	29.05.2025	Takim pune me përfaqësuesit e fshatit Stubëll e Epërme, me ç'rast është diskutuar për progresin e arritur në realizimin e kycjeve individuale të financuar nga vetë

			banorët e fshatit, si dhe përmundësinë që pas përfundimit të kycjeve të merret nën menaxhim nga KRU Hidromorava.
15.	ARRU	02.06.2025	Është mbajtur një takim pune me përfaqësuesit e ARRU-së, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga të gjitha KRU-të. Gjatë takimit, përmes një prezantimi, të gjitha KRU-të janë udhëzuar mbi hapat që duhet të ndërmarrin për përgatitjen e të dhënave në kuadër të procesit tarifor për periudhën 2026-2028.
16.	SHUKOS	02.06.2025	Është mbajtur një takim pune në SHUKOS, ku pika kryesore e diskutimit ka qenë nënshkrimi i marrëveshjeve me KEK-un për furnizimin me energji elektrike. Ky proces është rezultat i obligimit që të gjitha KRU-të të kalojnë në tregun e lirë të energjisë, duke marrë parasysh kushtin ligjor që i detyroni ndërmarrjet me mbi 50 të punësuar të realizojnë këtë tranzicion.
17.	Komuna Gjilân	03.06.2025	Është mbajtur një takim pune me Kryetarin e Komunës së Gjilânit, ku është diskutuar për punimet që janë duke u zhvilluar paralelisht nga Komuna e Gjilânit dhe KRU 'Hidromorava', me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve nëpër rrugët e qytetit. Po ashtu, duke marrë parasysh hyrjen në sezonin e verës dhe ardhjen e diasporës, e cila sjell rritje të ndjeshme të kërkesës për ujë, është diskutuar edhe për sigurimin e furnizimit të rregullt me ujë të pijshëm dhe adresimin e problemeve të furnizimit në disa lagje të larta të qytetit.
18.	FLAWS	04.06.2025	Është mbajtur një takim pune me përfaqësuesit e projektit FLAWS, ku temë kryesore e diskutimit ka qenë 'Plani Dinamik' i zhvillimit të punimeve dhe sfidat e projektit. Është konstatuar se dinamika e punimeve është e kënaqshme. Gjithashtu, janë shqyrtuar sfidat e realizimit të projektit dhe është vendosur që KRU 'Hidromorava' të paraqesë disa kërkesa shtesë, të cilat pritet të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së projektit.
19.	Samiti i Ujërave në Amsterdam	23&24.06.2025	Së bashku me U.D. Kryesuesin e Bordit dhe një anëtar të Bordit, kemi realizuar një udhëtim zyrtar jashtë vendit për të marrë pjesë në Samitin e Ujërave, të mbajtur në Amsterdam. Gjatë samitit, shumica e prezantimeve janë fokusuar në reduktimin e humbjeve teknike të ujit dhe në metodat moderne që aplikohen globalisht për identifikimin e rrjedhjeve.

20.	Komuna Kamenicë	26.06.2025	Është mbajtur një takim pune me Kryetarin e Komunës së Kamenicës, ku temë kryesore e diskutimit kanë qenë projektet në realizim dhe punët në proces në territorin e Komunës së Kamenicës. Gjatë takimit janë adresuar edhe sfidat e projektit të ujësjellësit në Karaçevë të Epërme, ku është kërkuar nga Operatorit Ekonomik që të përfundojë punimet deri më datë 30 shtator 2026.
21.	Komuna Gjilan	26.06.2025	Është mbajtur një takim pune me Kryetarin e Komunës së Gjilanit, ku temë diskutimi kanë qenë cilësia e furnizimit me ujë, projektet e përbashkëta që ndikojnë në përmirësimin e infrastrukturës së qytetit, si dhe çështje të tjera me interes të ndërsjellë për të dy institucionet.

1.3. Vendime dhe akte të tjera

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të tij, Kryeshefi Ekzekutiv gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, ka nxjerrë 15 vendime të listuara si më poshtë:

Tabela 2. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM2/2025

Nr.	Vendimi:	Numri i Vendimit:	Data e protokollimit:
1.	Në pajtim me nenin 67, pika 1.4 dhe nenin 72 të Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-212, punëtorit I.K. nga Gjilani, i sistemuar në vendin e punës "Lexues i ujëmatësve - shpërndarës i faturave", i ndërpritet marrëdhënia e punës me datë 28.03.2025, për shkak se i njëjti ka arritur moshën ligjore të pensionimit prej 65 vjetësh.	471	02.04.2025
2.	Vendim për caktimin e komisionit për verifikimin e materialit funksional dhe jofunksional në depo të KRU "Hidromorava"-Sh.A	478	03.04.2025
3.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e kandidatëve në procedurën e rekrutimit për pozitën punuese "Zyrtar për çertifikim të në KRU "Hidromorava"-Sh.A. në Gjilan, sipas konkursit publik nr. 473 të dt. 03.04.2023.	558	15.04.2025
4.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve në procedurën e rekrutimit për pozitën punuese Zyrtar për çertifikim të pagesave, nr.476 të dt.03.04.2025	581	22.04.2025

5.	Vendim për pezullimin e konkurseve publike nr.424,425, dhe 426 të datës 24.03.2025 për pozitën punuese Lexues i ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave, Teknik i shkyçjes dhe kontrollit, dhe punëtor i pakualifikuar - punëtor fizik në rrjetin e ujësjellësit.	613	30.04.2025
6.	Vendim për pezullimin e Konkursit Publik për pozitën punuese "Zyrtar për çertifikim të pagesave".	627	06.05.2025
7.	Vendim për shqiptimin e masës së largimit të përkohshëm nga puna për të punësuarin V.M. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese "Menaxher i Divizionit Komercial" në KRU "Hidromorava" Sh.A., konform Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan nr. 2025: 08880 të dt. 30.04.2025.	661	13.05.2025
8.	Vendim për aprovimin e pushimit pa pagesë, konform nenit 40 paragrafi 1.të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212. ndaj të punësuarit Xh.R. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese "Operator në FPU Përlepnice" në kohëzgjatje prej dy (2) muajve.	719	30.05.2025
9.	Vendim për shpalljen e Konkursit Publik për pozitën punuese "Drejtor Teknik" në KRU "Hidromorava" Sh.A.	737/1	04.06.2025
10.	Vendim për formimin e komisionit/ekipit për identifikimin e kycjeve ilegale në Nj.O. Viti".	742	10.06.2025
11.	Vendim për anulimin e konkurseve publike të pezulluara me nr. 424, 425 dhe 426 të dt. 24.03.2025, sipas Vendimit nr. 613 të dt. 30.04.2025 për pozitën punuese: "Lexues i ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave", "Teknik i shkyçjes dhe kontrollit" dhe , "Punëtor i pakualifikuar-punëtor fizik në ujësjellës" dhe konkursit publik me nr. 476 të dt. 03.04.2025, i pezulluar sipas Vendimit me nr. 627 të dt. 06.05.2025 për pozitën punuese "Zyrtar për çertifikim të pagesave".	777	20.06.2025
12.	Vendim për plotësim/ndryshimin e Vendimit nr. 1672 të dt. 27.11.2024, sa i përket përbërjes së komisionit për shqyrtimin dhe asgjësimin e dokumentacionit të arkivuar në KRU "Hidromorava" Sh.A.	779	20.06.2025
13.	Vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me të punësuarin z. I.L., i angazhuar në Njësinë Operative Viti, në pozitën 'Porto-arkatar', për shkak të plotësimit të kushteve ligjore - pensionim.	780	23.06.2025
14.	Vendim për caktimin e Komisionit për realizimin e inspektimeve në terren, me qëllim të identifikimit dhe ndërmarrjes së masave ndëshkuese ndaj keqpërdorimeve të ujit të pijshëm nga ana e konsumatorëve.	803	30.06.025

15.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve në procedurën e rekrutimit për poziten punëse "Drejtor Teknik", konform Konkursit Publik me nr. 739 të dt. 05.06.2025.	804	30.06.2025
-----	--	-----	------------

2. BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidromorava" gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, ka mbajtur tri /3/ mbledhje të rregullta.

Shënim: Ministria e Ekonomisë, mbështetur në nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/LL-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura në nenin 15.11 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në pajtim me pikat 13.6 dhe 13.7 të Shtojcës së rregullores (QRK) nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyres së Kryeministrit dhe ministrive, merr vendim për caktimin e z. Habil Zeqiri si Ushtrues Detyre i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve në KRU "Hidromorava" Sh.A., deri në emërimin e Kryesuesit ose emërimin e bordit të ri të drejtorëve nga Qeveria¹.

2.1.Vendimet e Bordit të Drejtorëve

Vendimmarrja në Bordin e Drejtorëve gjithmonë është bërë në mënyrë të lirë dhe demokratike duke e respektuar të drejtën e votimit të lirë, pa presion dhe vendosjes me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit.

❖ **Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e katërt të mbajtur me datë: 30.04.2025 ka marrë këto vendime:**

1. Unanimisht është miratuar Raporti i Punës për muajin mars të vitit 2025;

❖ **Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e pestë të mbajtur me datë: 28.05.2025 ka marrë këto vendime:**

1. Unanimisht është miratuar "Raporti i Tremujorit të parë (TM1) për vitin 2025";
2. Unanimisht është miratuar "Raporti i Auditimit të Jashtëm për pasqyrat financiare 2024 së bashku me Planin e Veprimt";
3. Unanimisht është miratuar Raporti i Punës për muajin prill të vitit 2025.

❖ **Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e gjashtë të mbajtur 27.06.2025 ka marrë këto vendime:**

1. Unanimisht është miratuar Raporti i Punës për muajin maj të vitit 2025.

❖ **Bordi i Drejtorëve në tremujorin e dytë të vitit 2025, përmes postës elektronike ka marrë këto vendime:**

1. Me datë 07.05.2025, Bordi i Drejtorëve unanimisht ka miratuar kërkesën e Menaxhmentit për "Ri-alokimin e mjeteve në Planin e Biznesit për vitin 2025"².

¹ Vendim me nr. Protokolli 2231 e dt. 21.05.2025 nga Ministria e Ekonomisë.

² Në maj 2025, u miratua ri-alokimi i mjeteve prej 50,000 € nga ndërtimi i rezervuarit në Arbëri, i cili u bë i panevojshëm për shkak të projektit FLOWS, për realizimin e kyçjeve individuale në Fshatin Uglar, duke mundur lidhjen e rreth 250 konsumatorëve të rinj.

3. KOMISIONI I AUDITIMIT

Komisioni i Auditimit gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, ka mbajtur një /1/ mbledhje të rregullt dhe bazuar në procesverbalin e datës: 22.05.2025 ka shqyrtuar këto çështje:

3.1. Vendimet e Komisionit të Auditimit

Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava" Sh.A., në mbledhjen e tretë të mbajtur më 22 maj 2025, ka shqyrtuar çështjet në vijim:

- "Raportin e Auditimit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare për vitin 2024 së bashku me Planin e Veprimit", i cili raport është miratuar unanimisht me plotësim/ndryshimet e kërkuara nga ana e anëtarëve të Komisionit të Auditimit;
- Është shqyrtuar "Draft Raporti i punës për tremujorin e parë të vitit 2025 për performancën operative dhe financiare të Ndërmarrjes" dhe janë dhënë komentet dhe rekomandimet, i cili Raport pastaj i është dorëzuar Bordit të Drejtorëve për shqyrtim dhe miratim;
- Draft raporti i Auditimit të Brendshëm: "Projekti i kyçjeve individuale për fshatrat: Roganë, Hodonoc, Muçivërcë, Dajkoc dhe Shipashnicë e Ulët, Komuna e Kamenices", i cili raport është miratuar unanimisht me plotësim/ndryshimet e propozuara nga ana e anëtarëve të Komisionit të Auditimit.

Komisioni i Auditimit, në tremujorin e dytë të vitit 2025, përmes postës elektronike ka shqyrtuar dhe marrë këto vendime:

- "Raporti Vjetor i Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 për KRU Hidromorava - Gjilan", është miratuar unanimisht me datë: 29.04.2025.

Shënim: Në bazë të Vendimit nr. 182, datë 28.02.2025, për emërimin e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm në KRU "Hidromorava" Sh.A., z. Avdyl Kastrati e ka filluar ushtrimin e detyrës më 01.04.2025.

4. ZYRA E SEKRETARES/DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, janë protokolluar dhe arkivuar 353 akte nga shërbimi juridik. Gjatë këtij tremujori janë mbajtur gjithsej nëntë /9/ mbledhje të rregullta të Menaxhmentit të Ndërmarrjes. Gjithashtu, janë nxjerrë akte si: urdhëresa, lajmërimë, njoftime, vërtetime të ndryshme konsumatorëve dhe punëtorëve të Ndërmarrjes për nevoja personale, vendime për pushime vjetore, autorizime, kërkesa, përgjigje në kërkesa dhe ankesa të ndryshme. Gjatë periudhës raportuese, Zyra e Sekretares në kuadër të aktiviteteve të saja nuk ka pasur lëndë për iniciimin e propozimeve për përmbardim e as lëndë për iniciimin e kallëzimeve penale, ndërsa në zyrën për konsumatorë janë pranuar 15 ankesa me shkrim, me ç'rast Komisioni për shqyrtimin e ankesave i ka shqyrtuar të gjitha.

4.1. Struktura e të punësuarve

KRU "Hidromorava" Sh.A Gjilan, gjatë kësaj periudhe ka operuar me gjithsej 159 të punësuar.

Tabela 3. Numri i të punësuarve në njësitë punuese gjatë periudhës së TM2/2025

Numri i të punësuarve në njësitë e caktuara punuese	Gjilan	Kamenicë	Viti
	124 ³	16	19 ⁴

Tabela 4. Struktura gjinore e të punësuarve gjatë periudhës së TM2/2025

Numri i të punësuarve sipas përkatësisë gjinore	Numri i të punësuarve (meshkuj)	Numri i të punësuarve (femra)
	135	24

4.2. Çështjet gjyqësore

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, KRU "Hidromorava" - SH.A. në Gjilan, nga ana e gjykatave kompetente ka pranuar lëndët e paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5. Lëndët e pranuar nga Gjykatat kompetente gjatë periudhës së TM2/2025

Lëndët e pranuar nga gjykatat kompetente			
Datë	Institucioni	Nr. Aktvendimit/ Aktgjykimit	Arsyetime

³ Rritja e numrit të të punësuarve nga 123 në TM1/2025 në 124 në TM2/2025 ka ardhur si rezultat i emërimit të Zyrtarit për Auditim të Brendshëm, z. Avdyl Kastrati, konform Vendimit nr. 182, datë 28.02.2025, i cili ka filluar detyrën më 01.04.2025.

⁴ Ulja e numrit të të punësuarve në Nj.O. Viti është rezultat i ndërprerjes së marrëdhënies së punës me z. Izjah Islami, konform Vendimit nr. 780, datë 23.06.2025, për shkak të përbushjes së kushteve ligjore për pensionim.

03.04.2025	Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative	A.nr.2145/2022 i dt.12.03.2025	Me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me nr. A.nr. 2145/2022, të datës 12.03.2025, është refuzuar si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit Ismet Azizi nga Gjilani, e ushtruar ndaj të paditurës KRU "Hidromorava" SH.A - Gjilan, me qëllim anulimin e vendimit të marrë nga ARRU-ja nr. 160/22, datë 22.08.2022, që kishte të bënte me parashkrimin e borxhit.
11.04.2025	Gjykata e Apelit e Kosovës - Prishtinë	CAP.nr.1421/2024 i dt.24.03.2025	Me Aktvendimin CAP.nr. 1421/2024, të datës 24.03.2025, Gjykata e Apelit në Prishtinë ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit Gëzim Muji nga Gjilani, duke prishur Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK.nr. 55/2023, të datës 27.05.2024. Si rrjedhojë, lënda i kthehet Gjykatës Themelore në Gjilan për procedim të sërishëm, lidhur me borxhin në shumë prej 1,832.41 €.
06.05.2025	Gjykata Themelore në Gjilan	CPP. Nr. 30/2025 i dt.30.04.2025	Me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, me nr. CPP.nr. 30/2025, të datës 30.04.2025, është hedhur poshtë si i palejuar prapësimi i debitorit Gëzim Muji nga Gjilani, i paraqitur kundër kreditorit KRU "Hidromorava" SH.A, në lidhje me procedurën e përbarimit mbi bazën e dokumentit të besueshëm, për një borxh në shumë prej 1,832.41 €.
08.05.2025	Gjykata Komeriale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë	KPPP.nr.860/24 e dt. 29.04.2025	Me Aktvendimin e Gjykatës Komeriale të Kosovës - Dhomat e shkallës së parë, me nr. KPPP.nr. 860/24, të datës 29.04.2025, është refuzuar në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit KRU "Hidromorava" SH.A, i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 207/24, datë 15.05.2024, të lëshuar nga Përbaruesi Privat, për një borxh në shumë prej 100,000.00 €. Kundër këtij aktvendimi, debitori KRU "Hidromorava" SH.A, me seli në Gjilan, ka ushtruar ankesë pranë Gjykatës Komeriale - Shkalla e Dytë.
19.05.2025	Prokuroria Themelore Gjilan - Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim	PP.II 506/2025 e dt. 19.05.2025	Prokuroria Themelore në Gjilan, në bashkëpunim me palët - KRU "Hidromorava" SH.A në Gjilan dhe të pandehurin Besnik Pira nga fshati Pozhoran - ka arritur një marrëveshje ndërmjetësimi për kompensimin e dëmit, si pasojë e dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve publike, sipas nenit 314, paragrafi 1 në lidhje me paragrafin 6 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

21.05.2025	Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë	C.nr. 40/2025 e dt.15.05.2025	Me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, me nr. C.nr. 40/2025, të datës 15.05.2025, është pranuar padia e paditësit Flamur Vranja nga fshati Hogosht, Komuna e Kamenicës, e ushtruar kundër të paditurës KRU "Hidromorava" SH.A - Gjilan, me kërkesë për anulimin e vendimit, kompensim dëmi, si dhe kthim në vendin e punës, në pozitën Arkatar ndihmës në njësinë në Kamenicë.
09.06.2025	Gjykata Themelore në Gjilan	CPK.nr.13/2025 i dt. 23.04.2025	Me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, me nr. CPK.nr. 13/2025, të datës 23.04.2025, është refuzuar si i pabazuar prapësimi i paraqitur më 05.10.2022 nga debitori Sahit Sahiti nga Gjilani, kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 248/2022, të datës 07.03.2023, lidhur me borxhin ndaj kreditorit KRU "Hidromorava" SH.A, në shumë prej 712.24 €.
24.06.2025	Gjykata e Apelit të Kosovës - Prishtinë	CAP.nr.1879/2024 i dt.23.05.2025	Me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, me nr. CAP.nr. 1879/2024, të datës 23.05.2025, është refuzuar si e pabazuar ankesa e kreditorit KRU "Hidromorava" SH.A, ushtruar kundër debitores Imrije Krasniqi nga Kamenica. Në të njëjtën kohë, është vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, me nr. PPP.nr. 32/21, të datës 29.08.2024, duke shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor në pjesën që ka të bëjë me shumën prej 1,550.12 €, ndërsa është lënë në fuqi urdhri përmbarimor në shumë prej 263.35 €.

5. DEPARTAMENTI FINANCIAR

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, në Departamentin Financiar janë realizuar aktivitetet:


- kontrollimi dhe barazimi i llogarive të pagueshme dhe llogarive të arkëtueshme;
- raportet ditore nga shërbimi i arkave;
- barazimi i gjendjeve bankare;
- kontimet;
- shkarkimet nga pagesat të cilat transferohen nga insitucionet mikrofinanciare dhe bankare;
- kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre;
- përgatitjet e pagave;
- plotësimi i librave të blerjes dhe shitjes sipas formës së kërkuar nga ATK-ja për muajin përkatës dhe tremujore;
- deklarimi i tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave sipas ligjit në fuqi.

5.2. Shqyrtimi performancës operative dhe financiare

5.2.1. Prodhimi i ujit në m³

Prodhimi i ujit në m³ për TM2/2025 në krahasim me TM2/2024 ka rritje për 1.33 %, ndërsa sa i përket arritjes së cakut të planifikuar është përmbushur 92.98%.


Tabela 6. Paraqitja grafike e prodhimit të ujit në m³



5.2.2. Faturimi i ujit në m³

Faturimi i ujit në m³ për TM2/2025 në krahasim me TM2/2024 ka shënuar rënie për 0.76 %, ndërsa sa i përket arritjes së cakut të planifikuar, është realizuar 80.37 %.


Tabela 7. Paraqitja grafike e faturimit të ujit në m³



5.2.3. Faturimi i ujit në euro (€)

Faturimi i ujit në euro (€) në TM2/2025 në krahasim me TM2/2024 ka rritje 13.43 %, ndërsa sa i përket realizimit të planit, ai është arritur në masën 93.15 %.


Tabela 8. Paraqitja grafike e faturimit në euro (€)



5.2.4. Arkëtimi i ujit

Arkëtimi i ujit për TM2/2025 në krahasim me TM2/2024 ka shënuar rritje për 12.25%. Arkëtimi nga borxhet e vjetra ka ndikuar në rritje të normës së arkëtimit, ndërsa sa i përket realizimit të planit, është realizuar 83.67 %


Tabela 9. Paraqitja grafike e arkëtimit të ujit



5.2.5. Përqindja e arkëtimit

Përqindja e arkëtimit nga faturimi për TM2/2025 në krahasim me TM2/2024 ka rrënie për 0.99 %, ndërsa sa i përket realizimit të planifikuar 97.72 %.

Tabela 10. Paraqitja grafike e përqindjes së arkëtimit



5.2.6. Shpenzimet

Shpenzimet në TM2/2025 në krahasim me TM2/2024, kanë shënuar rritje për 5.31 %, Ndërsa me planin janë më të ulëta për 10.41 %.

Tabela 11. Paraqitja grafike e shpenzimeve në €




Tabela 12. Raporti i performancës operative dhe financiare për regionin TM2/2025 dhe TM2/2024 dhe planin TM2/2025

	Indikatorët - Region	TM2/2025	TM2/2024	Realizimi 2025/2024	Trendi 2025/2024	Plani TM2/2025	Realizimi i planit [%]	Trendi 2025 me Planin
1	Prodhimi i ujit [m ³]	2,324,464	2,293,844	101.33	Poz	2,500,000	92.98	Neg
2	Faturimi [m ³]	1,070,537	1,078,730	99.24	Neg	1,332,000	80.37	Neg
3	Uji i pafaturar [m ³]	1,253,927	1,215,114	103.19	Neg	1,168,000	93.15	Neg
4	Faturimi [€]	704,017	620,670	113.43	Poz	841,465	83.67	Neg
5	Arkëtimi [€]	665,433	592,798	112.25	Poz	813,902	81.76	Neg
6	Shkalla e arkëtimit [%] ⁵	94.52	95.51	98.96	Neg	96.72	97.72	Neg
7	Shpenzimet operative [€] ⁶	549,481	521,754	105.31	Neg	606,661	110.41	Poz
8	Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	44,510	42,667	104.32	Poz	43,783	101.66	Poz
9	Numri i konsumtorëve me ujëmatës[nr]	40,403	38,649	104.54	Poz	40,246	100.39	Poz
10	Numri i konsumtorëve me konsum zero [nr]	18,810	19,361	97.15	Poz	18,850	100.21	Poz
11	Konsumatorë të rinj [nr]	476	395	120.51	Poz	120	396.67	Poz
12	Numri i konsumatorëve aktiv [nr]	40,521	38,814	104.40	Poz	40,340	100.45	Poz
13	Numri i konsumatorëve pa matje [nr]	118	165	71.52	Poz	60	50.85	Neg
14	Faturimi i ujit me ujëmatës [m ³]	1,067,432	1,048,631	101.79	Poz	1,328,137	80.37	Neg
15	Proportioni i konsumatorëve me ujëmatës [%]	99.71	99.57	100.13	Poz	99.77	99.94	Neg
16	UPF në [%]	53.94	52.97	101.83	Neg	46.72	86.61	Neg
17	Norma e Mbulimit operativ	1.21	1.14	106.59	Poz	1.34	90.27	Neg
18	Diferenca faturimi/shpenzimet operative €	154,536	98,916	190.85	Poz	234,804	65.81	Neg
19	Diferenca arkëtimi/shpenzimet operative €	115,952	71,044	211.41	Poz	207,241	55.95	Neg
20	Kostoja për Njësi [€/m ³]	0.23	0.23	100.00	Poz	0.24	105.51	Poz
21	Efikasiteti i stafit [°000 kons]	4.35	4.51	96.45	Poz	4.47	102.76	Poz

⁵ Pavarësisht se janë arkëtuar më shumë mjete monetare në krahasim me TM2 2025 shkalla e arkëtimit ka shënuar rënie si rezultat i rritjes së vlerës së faturimit.

⁶ Shpenzimet operative, përjashtuar energjinë elektrike, kanë shënuar ulje në krahasim me periudhat e mëparshme, por shpenzimet për energji elektrike kanë ndikuar në rritje të ndjeshme si pasojë mirjes në konsideratë të 50% të vlerës së garancionit të paguar paraprakisht, si kosto e mundshme për energjinë e konsumuar gjatë periudhës.

Tabela 13, Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësine e Gjilanit TM2/2025 dhe krahasimi me TM2/2024

	Indikatorët - Gjilan	TM2/2025	TM2/2024	Realizimi 2025/2024	Trendi 2025/2024
1	Prodhimi i ujit [m³]	1,676,570	1,698,277	98.72	neg
2	Faturimi [m³]	840,996	844,669	99.57	neg
3	Uji i pafaturar [m³]	835,574	853,608	97.89	neg
4	Faturimi [€]	558,525	492,919	113.31	poz
5	Arkëtimi [€]	550,364	497,500	110.63	poz
6	Shkalla e arkëtimit [%]	98.54	100.93	97.63	neg
7	Shpenzimet operative [€]	421,980	399,177	105.71	neg
8	Numri i konsumatorëve të regjistruar (total)	33,964	32,640	104.06	poz
9	Numri i konsumatorëve me ujëmatës [nr]	31,628	30,386	104.09	poz
10	Numri i konsumatorëve me konsum zero [nr]	14,322	14,846	96.47	poz
11	Konsumatorë të rinj [nr]	328	263	124.71	poz
12	Numri i konsumatorëve aktiv [nr]	31,683	30,445	104.07	poz
13	Numri i konsumatorëve pa matje [nr]	55	59	93.22	poz
14	Faturimi i ujit me ujëmatës [m³]	836,793	836,785	100.00	poz
15	Proportioni i konsumatorëve me ujëmatës [%]	99.83	99.81	100.02	poz
16	UPF në [%]	49.84	50.26	99.15	poz
17	Norma e mbulimit operativ	1.32	1.23	107.19	poz
18	Diferenca faturimi/shpenzimet operative €	136,545	93,742	145.66	poz
19	Diferenca arkëtimi/shpenzimet operative €	128,384	98,323	130.57	poz
20	Kostoja për Njësi [€/m³]	0.25	0.24	107.57	neg
21	Efikasiteti i stafit ['000 kons]	4.14	4.40	94.06	poz

Tabela 14. Raporti i performancës operative dhe financiar për Njësinë e Kamenicës TM2/2025 dhe krahasimi me TM2/2024

	Indikatorët - Kamenicë	TM2/2025	TM2/2024	Realizimi 2025/2024	Trendi 2025/2024
1	Prëdhimi i ujit [m ³]	236,454	203,467	116.21	poz
2	Faturimi [m ³]	117,307	112,209	104.54	poz
3	Uji i pafaturar [m ³]	119,147	91,258	130.56	neg
4	Faturimi [€]	70,830	60,530	117.02	poz
5	Arkëtimi [€]	62,314	50,664	122.99	poz
6	Shkalla e arkëtimit [%]	87.98	83.70	105.11	poz
7	Shpenzimet operative [€]	67,039	67,981	98.61	poz
8	Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	5,464	5,370	101.75	poz
9	Numri i konsumtorëve me ujëmatës [nr]	4,328	4,265	101.48	poz
10	Numri i konsumtorëve me konsum zero [nr]	2,135	2,132	100.14	neg
11	Konsumatorë të rinj [nr]	20	11	181.82	poz
12	Numri i konsumtorëve aktiv [nr]	4,328	4,265	101.48	poz
13	Numri i konsumtorëve pa matje [nr]	0.00	0.00	n/a	n/a
14	Faturimi i ujit me ujëmatës [m ³]	117,307	112,210	104.54	poz
15	Proportioni i konsumtorëve me ujëmatës [%]	100.00	100.00	100.00	poz
16	UPF në [%]	50.39	44.85	112.35	neg
17	Norma e mbulimit operativ	1.06	0.89	118.66	poz
18	Diferenca faturimi/shpenzimet operative €	3,791	-7,451	180.90	poz
19	Diferenca arkëtimi/shpenzimet operative €	-365	-17,317	97.90	neg ⁷
20	Kostoja për Njësi [€/m ³]	0.25	0.33	76.18	poz
21	Efikasiteti i stafit ['000 kons]	4.22	4.52	93.40	poz

⁷ Edhe pse rezultati financiar për periudhën mbetet negativ, humbja është zvogëluar nga -17,317€ në periudhën paraprake në vetëm -365€ në TM2 duke reflektuar një trend përmirësues të qëndrueshëm.

Tabela 15. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë e Vitit për TM2/2025, krahasimi me TM2/2024

	Indikatorët - Viti	TM2/2025	TM2/2024	Realizimi 2025/2024	Trendi 2025/2024
1	Prodhimi i ujit [m ³]	411,440	392,100	104.93	poz
2	Faturimi [m ³]	112,234	121,852	92.11	neg
3	Uji i pafaturar [m ³]	299,206	270,248	110.72	neg
4	Faturimi [€]	74,662	67,221	111.07	poz
5	Arkëtimi [€]	52,755	44,634	118.19	poz
6	Shkalla e arkëtimit [%]	70.66	66.40	106.42	poz
7	Shpenzimet operative [€]	57,403	54,937	104.49	neg
8	Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	5,082	4,657	109.13	poz
9	Numri i konsumtorëve me ujëmatës [nr]	4,447	3,998	111.23	poz
10	Numri i konsumtorëve me konsum zero [nr]	2,353	2,383	98.74	poz
11	Konsumatorë të rinj [nr]	128	121	105.79	poz
12	Numri i konsumtorëve aktiv [nr]	4,510	4,104	109.89	poz
13	Numri i konsumtorëve pa matje [nr]	63	106	59.43	poz
14	Faturimi i ujit me ujëmatës [m ³]	112,219	99,636	112.63	poz
15	Proportioni i konsumtorëve me ujëmatës [%]	98.60	97.42	101.22	poz
16	UPF në [%]	72.72	68.92	105.51	neg
17	Norma e mbulimit operativ	1.23	1.22	100.62	poz
18	Diferenca faturimi/shpenzimet operative €	14,021	12,284	114.14	poz
19	Diferenca arkëtimi/shpenzimet operative €	-7,886	-10,303	23.50	neg ⁸
20	Kostoja për Njësi [€/m ³]	0.14	0.14	100.00	poz
21	Efikasiteti i stafit ['000 kons]	5.36	5.40	99.27	poz

⁸ Edhe pse rezultati financiar për periudhën mbetet negativ, humbja është zvogëluar nga -10,303€ në periudhën paraprake në -7,886 € në TM2 duke reflektuar një trend përmirësues.

PASQYRA E POZITËS FINACIARE MË 30 QERSHOR 2025

	Shënimi	TM2/2025 €	TM2/2024 €
PASURITË			
Pasuritë afat shkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parësë	1	1,034,198.00	717,658.00
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	2	3,178,886.00	3,491,370.00
Stoqet	3	491,493.00	434,647.00
Pasuritë e tjera afat shkurtra	4	101,234.00	104,411.00
Gjithsej pasuritë afat shkurtra		4,805,811.00	4,748,086.00
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	5	46,845,731.00	7,418,234.00
Prona investuse			
Investimet në vijim	6	2,277,427.00	1,949,774.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë e shtyra tatimore			
Pasuritë e tjera afatgjata			
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		49,123,158.00	9,368,008.00
Gjithsej pasuritë		53,928,969.00	14,116,094.00
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afat shkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	7	123,698.00	180,449.00
Kreditë dhe huatë, pjesa afat shkurtër			-
Tatimet e pagueshme aktuale		-	-
Të hyrat e shtyra		-	-
Provizionet afatshkurtra			
Detyrimet e tjera afatshkurtra		129,873.00	118,370.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra	8	253,571.00	298,819.00
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë			-
Provizionet afatgjata			-

Detyrimet ndaj lizingut pjesë afatgjatë			
Detyrimet nga e shtyra (grantet)	9	6,813,118.00	6,061,167.00
Detyrime tjera afatgjata		-	-
Gjithsej detyrimet afatgjata		6,813,118.00	6,061,167.00
Gjithsej detyrimet		7,066,689.00	6,359,986.00
EKUITETI			
Kapitali aksionar		25,000.00	25,000.00
Fitimet/Humbjet e bartura		(93,857.00)	(318,411.00)
Rezerva të tjera		8,049,519.00	8,049,519.00
Rezervat e Rivlerësimit		38,881,618.00 ⁹	-
Gjithsej ekuiteti	10	46,862,280.00	7,756,108.00
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		53,928,969.00	14,116,094.00

⁹Vlera e rivlerësimit të aseteve.

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHË PËRFSHIRËSE MË 30 QERSHOR 2025

	Shënim	TM2/2025 €	TM2/2024 €
	11	697,484.00	610,408.00
Të hyrat			
Të hyrat e tjera		18,005.00	18,077.00
Të hyrat nga grantet		119,485.00	108,780.00
Total te hyrat		834,974.00	737,265.00
		-	-
Shpenzimet e shpërndarjes (personelit)	12	(381,025.00)	(375,424.00)
Shpenzimet administrative (zhvlerësimit)	13	(187,947.00)	(166,643.00)
Shpenzime të energjisë elektrike	14	(87,577.00) ¹⁰	(68,664.00)
Shpenzimet e mirëmbajtjes	15	(17,983.00)	(19,136.00)
Shpenzimet e kemikateve/derivate/analizat e ujit	16	(27,871.00)	(24,225.00)
Shpenzimet e tjera operative	17	(41,088.00)	(38,282.00)
Total shpenzimet		(743,491.00)	(692,374.00)
Fitimi /(humbja) operative		91,483.00	44,891.00
Shpenzimet financiare		-	-
Të ardhurat financiare		-	-
Fitimi/Humbja para tatimit	18	91,483.00	44,891.00
Shpenzimet e tatimit ne fitim		-	-
Fitimi /(humbja) i/e periudhës		91,483.00	44,891.00
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare të operacioneve të huaja neto nga tatimi			
Të ardhurat tjera gjithë përfshirëse të periudhes		-	-
Gjithsej të ardhurat/(humbjet) gjithëpërfshirëse të periudhës		-	-

¹⁰ Shpenzimet operative, përjashtuar energjinë elektrike, kanë shënuar ulje në krahasim me periudhat e mëparshme, por shpenzimet për energji elektrike kanë ndikuar në rritje të ndjeshme si pasojë mrrjes në konsideratë të 50% të vlerës së garancionit të paguar paraprakisht, si kosto e mundshme për energjinë e konsumuar gjatë periudhës.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET MË 30 QERSHOR 2025

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e rivleresuara	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€	€
Gjendja më 31 mars 2024	25,000.00	(363,302.00)		8,049,519.00	7,711,217.00
Fitimi/(Humbja) i/e vitit (TM2/2024)		44,891.00			44,891.00
Diferencat nga për kthimet valutore	-	-	-	-	-
Dividentat	-	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-	-
Ndarje e rezervave	-	-	-	-	-
Gjendja më 30 Qershor 2024	25,000.00	(318,411.00)		8,049,519.00	7,756,108.00
Gjendja më 31 Mars 2025	25,000.00	(185,340.00)	38,881,618.00	8,049,519.00	46,770,797.00
Fitimi/(Humbja) i/e vitit (TM2/2025)	-	91,483.00	-	-	91,483.00
Diferencat nga për kthimet valutore	-	-	-	-	-
Dividentat	-	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-	-
Ndarje e rezervave	-	-	-	-	-
Gjendja më 30 Qershor 2025	25,000.00	(93,857.00)	38,881,618.00	8,049,519.00	46,862,280.00

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË MË 30 QERSHOR 2025

	Shënimi	TM2/2025 €	TM2/2024 €
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi/(Humbja) i/e periudhes	19	91,483.00	44,891.00
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			-
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	20	187,947.00	166,643.00
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	-
Amortizimi i pasurive të paprekshme		-	-
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese		38,881,618.00	-
Të ardhurat financiare		-	-
Shpenzimet financiare		-	-
(Fitimi) humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve		-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
		39,195,293.00	211,534.00
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja)/zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	21	312,484.00	299,728.00
(Rritja)/zvogëlimi në stoke	22	(56,846.00)	(87,215.00)
(Rritja)/zvogëlimi në pasuritë e tjera		3,177.00	(14,620.00)
Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	23	(56,751.00)	69,265.00
Rritja/(zvogëlimi) në detyrimet e tjera	24	11,503.00	22,584.00
Rritja/(zvogëlimi) në detyrimet e tjera nga grantet		751,951.00	1,266,392.00
Tatimi në fitim i paguar		-	-
Interesi i paguar		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		40,160,811.00	1,767,668.00
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		(327,653.00)	(877,119.00)

Arkëtimet për shitjen e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(39,482,373.00)	(684,361.00)
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme	-	-
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme	-	-
Interesi i arkëtuar	-	-
Dividentat e paguara	-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	(39,810,026.00)	(1,561,480.00)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-
Dividentat e paguara	-	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	-	-
Ripagimi i kredive dhe huave	-	-
Pagesat e lizingut financiarë		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	-	-
Rritje/(zvogëlim) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	316,540.00	206,188.00
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës	717,658.00	511,470.00
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të periudhës	1,034,198.00	717,658.00

5.3. Shpalosje e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare me 30 qershor 2025

Shënimet shpjeguese 1. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Tabela 16. Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paranë në banka dhe në arkë

	TM2/2025	TM2/2024
Paraja dhe ekuivalentët e parasë		
Porto arkat	2,663.17	2,134.00
Bankat	1,031,534.83	715,524.00
	1,034,198.00	717,658.00

Shënimet shpjeguese 2. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat e tjera

Tabela 17. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera

	TM2/2025	TM2/2024
Llogaritë e arkëtueshme	7,981,946.00	8,078,243.00
Provizioni i llogarive - amvisëri	3,626,098.00	3,607,876.00
Provizioni i llogarive - biznes	378,696.00	378,696.00
Provizioni i llogarive - institucion	447,985.00	447,985.00
Lejimet e bartura për shërbimet	152,016.00	152,016.00
Total provizioni	4,604,795.00	4,586,873.00
Neto të arkëtueshmet	3,178,886.00	3,491,370.00

Shënimet shpjeguese 3. Stoqet

Vlera e stoqeve paraqitet në pasqyrat financiare në vlerën më të ulët ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme nënkupton çmimin e shitjes në kushte normale të tregut, i zvogëluar për kostot e përfundimit të produktit, marketingut dhe shpërndarjes.

Kostoja e stoqeve, në parim, është përcaktuar sipas metodës së çmimit mesatar

Tabela 18. Stoqet

Përshkrimi - stoqet	TM2/2025 Vlera në €	TM2/2024 Vlera në €
Depo Kamenicë	69,321.23	51,351.22
Depo donacion	-	-
Depo Baja - kemikale	259.19	-
Depo e mbyllur Gjilan	225,189.43	185,135.20
Depo e hapur Gjilan	25,706.10	30,605.06
Depo administrative	1058.43	187.96
Depo materiale jo funksionale	546.73	13.51
Depo tek Penda	37,414.09	37,371.59
Depo Përlepnice, Gjilan	45,559.88	56,768.88
Depo Viti	66,846.81	57,022.11
Material depo Velekincë/Gjilan	7,653.31	6,999.64
Material revers	5,174.13	2,428.38
Depo Punëtorja e Ujëmatësve	6,763.67	6,763.67
	-	-
Gjithsej	491,493.00	434,647.00

Shënimet shpjeguese 4. Pasuritë tjera afatshkurta

Tabela 19. Pasuritë tjera afatshkurta

	TM2 2025	TM2 2024
Tatimi në fitim	37,020.00	34,756.00
Tatime në qira	107.00	90.00
Parapagimet e marra	59,998.00	65,466.00
Paradhënie të pranuar	4,109.00	4,099.00
Gjithsej	101,234.00	104,411.00

Shënimet shpjeguese 5. Pasuritë afatgjata - Pronat, impiantet dhe pajisjet

Tabela 20. Pronat, impiantet dhe pajisjet

	TM2/2025	TM2/2024
Gjithsej	10,553,796.94	7,515.86
Toka	5,270,695.00	1,902,000.00
Ndërtesa	15,933,532.00	4,953,021.00
Rrjeti i ujësjellësit, instalime teknike, makineri, pajisje	29,350,362.00	9,677,819.00
Mjete transporti	603,566.00	418,427.00
Mobile dhe pajisje zyre	395,482.00	198,729.00
Pajisje informative	118,965.00	58,312.00
Rrjeti i ujësjellësit	17,591.00	15,909.00
Rrjeti i kanalizimit	5,716,845.00	
Pasuritë afatgjata para zhvlerësimit	57,407,038.00	17,224,217.00
Zhvlerësimi i akumuluar	(10,561,307.00)	(9,805,982.00)
Gjithsej pasuritë	46,845,731.00	7,418,235.00

Shënimet shpjeguese 6. Investimet në vijim/projektet

	TM2/2025	TM2/2024
Përshkrimi		
Investimet në vijim	2,277,427.00	1,949,774.00
Gjithsej	2,277,427.00	1,949,774.00

Kontrata	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cërnice – Komuna e Gjilanit
Kontrata	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Karaçevë e Epërme në Komunën e Kamenicës
Kontrata	Shtimi i kapacitetit të ujit përmes restaurimit të rezervuarit, hapjës së puseve dhe ndërtimi i rrjetit në Berivojcë
Kontrata	Ndërrimi (zëvendësimi) i gypave të ujësjellësit dhe ri kyçjet individuale DN80 mm AC deri DN 200 mm PE
Kontrata	Shtimi i kapacitetit të ujit përmes restaurimit të rezervuarit, hapjës së puseve dhe ndërtimit të rrjetit në Berivojcë – Aneks Kontratë
Kontrata	Kyçjet (e rrugëve apo shtëpive individuale përgjatë kolektorit fshati Livoç i Epërm – Livoç i Ulët – Kodra e Thatë gjatësi 800m)
Kontrata	Ndërtimi dhe rehabilitimi i rezervuarëve në Kamenicë
Kontrata	Ndërtimi i kanalizimit në shtratin e lumit Dobërçan - Gjilan
Kontrata	Impianti i ujërave të zeza – ITUZ
Kontrata	Hartimi, ndërrimi i gypave dhe rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, brenda zonës së shërbimit.
Kontrata	FLAWS-CS-CQ-09

Shënimet shpjeguese 7. Llogaritë e pagueshme për TM2/2025

Tabela 21. Llogaritë e pagueshme

Emertimi i Furnitorit	Detyrimi
"TEUTA-M" Sh.P.K.	41,270.80
"Xerxa Hidro Group"	15,255.07
"ENG BAU" Sh.P.K.	14,789.00
"SEYKOS" Sh.P.K.	12,550.00
"Interlab" Sh.P.K.	7,430.00
"Panamic ICT"	5,780.00
"Hidroterm" Sh.P.K.	3,432.00
IKSHP	4,644.58
Telekomi i Kosovës	1,850.98
Tatimi në Pronë	1,284.75
"Ejona" Sh.P.K.	1,089.98
BI "Hajredin Leka"	1,014.60
"Eurotec" Sh.P.K.	781.35
Furnitorë nën vlerën 700 €	12,524.89
Gjithsej	123,698.00

Shënimet shpjeguese 8. Detyrimet afatshkurtra

Tabela 22. Detyrimet afatshkurtra

Përshkrimi	TM2/2025	TM2/2024
Llogaritë e pagushme	123,698.00	180,449.00
Detyrimet tjera afatshkurta	129,873.00	118,370.00
Gjithsej	253,571.00	298,819.00

Shënimet shpjeguese 9. Të hyrat e shtyra/grantet

Tabela 23. Të hyrat e shtyra/grantet

Përshkrimi	TM2/2025	TM2/2024
Të hyrat e shtyra në fillim të vitit	6,813,118.00	6,061,167.00
Të hyrat e shtyra më 30 qershor 2025	6,813,118.00	6,061,167.00

Shënimet shpjeguese 10. Ekuiteti

Tabela 24. Ekuiteti

	TM2/2025	TM2/2024
Ekuiteti me 30 qershor 2025	46,862,280.00	7,756,108.00
	46,862,280.00	7,756,108.00

Shënimet shpjeguese 11. Të hyrat

Tabela 25. Të hyrat

	TM2/2025	TM2/2024
Të hyrat nga shitja e ujit	697,484.00	610,408.00
Të hyrat nga shërbimet	18,005.00	18,077.00
Të hyrat nga grantet	119,485.00	108,780.00
Të hyrat totale	834,974.00	737,265.00

Shënimet shpjeguese 12. Shpenzimet e shpërndarjes

Tabela 26. Shpenzimet e shpërndarjes

	TM2/2025	TM2/2024
Shpenzimet e personelit	(381,025.00)	(375,424.00)

Shënimet shpjeguese 13, 14, 15, 16, 17. Administrative dhe tjera

Tabela 27. Shpenzime administrative tjera

Shpenzimet e energjisë [2]	(87,757.00)	(68,664.00)
Shpenzimet për derivate	(8,546.00)	(9,110.00)
Shpenzimet për kemikate	(8,173.00)	(9,467.00)
Shpenzimet për analiza të ujit	(11,597.00)	(5,506.00)
Ngarkesa për shërbime të ARRU-së MMPH	(7,415.00)	(7,928.00)
Shpenzime të kontraktuara	(5,321.00)	(2,570.00)
Shpenzimet e qirasë	(2,549.00)	(3,503.00)
Shpenzimet e materialit të konsumueshme	(1,546.00)	(1,401.00)
Ngarkesa për shërbime të SHUKOS-it	(1,350.00)	-
Shpenzime të tjera direkte	(6,616.00)	(6,172.00)
Shpenzimet për mirëmbajtje	(17,983.00)	(19,129.00)
Shpenzime të reprezentacionit/udhëtime zyrtare	(5,199.00)	(2,313.00)
Shpenzimet për telefon dhe internet	(2,506.00)	(3,814.00)
Shpenzimet e provizionit/përmbaruesit	(877.00)	(876.00)
Shpenzimet e materialit administrativ	(1,021.00)	(1,810.00)
Gjithsej	(168,456.00)	(142,263.00)

Shënimet shpjeguese 18 - Fitimi(humbja) para tatimit e vitit

Tabela 28. Fitimi (humbja) para tatimit

30.06.2025	44,891.00
30.06.2024	91,483.00

Shpalosja e ndryshimeve në ekuitet

Tabela 29. Ndryshimet në ekuitet

Kapitali aksionar	8,049,519.00
Fitimi i vitit paraprak	44,891.00
Fitimi/humbjet e bartura	(185,340.00)
Fitimi/humbja e vitit aktual	91,483.00
Fitimi/humbjet e bartura	(93,857.00)

Shënimet shpjeguese 19 – Fitimi/humbja e vitit – shpalosje në shënimin nr.18

Shënimet shpjeguese 20 – Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve – shpalosje në shënimin nr.5.

Shënimet shpjeguese 21 – Rritje/zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme – shpalosje shënimi nr.2.

Shënimet shpjeguese 22 – Rritje/zvogëlim në stoqe – shpalosje shënimi nr.3

TM2/2025	Stoqet	491,493.00
TM2/2024	Stoqet	434,647.00
30.06.2025	Rritje e stoqeve	56,846.00

Shënimet shpjeguese 23 – Rritje/zvogëlim në llogaritë e pagueshme tregtare – shpalosje shënimi nr.7

TM2/2025	Llogaritë e pagueshme dhe tregtare	123,698.00
TM2/2024	Llogaritë e pagueshme dhe tregtare	180,449.00
30.06.2025	Rritje e llogarive të pagueshme dhe tregtare	-56,751.00

Shënimet shpjeguese 24 – Rritje/zvogëlim në detyrimet e tjera – shpalosje në shënimin nr. 8

TM2/2025	Detyrimet tjera afatshkurtra	129,873.00
TM2/2024	Detyrimet tjera afatshkurtra	118,370.00
30.06.2025	Rritje/zvogëlim në detyrime tjera	11,503.00

6. ZYRA E PROKURIMIT

Zyra e Prokurimit gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, ka pranuar disa kërkesa me shkrim, për furnizime, shërbime dhe punë, nga njësitë përkatëse të cilat janë inicuar nga menaxhmenti i Ndërmarrjes, ku këto kërkesa pastaj janë proceduar varësisht prej prioriteteve dhe konform rregullave të prokurimit.

Tabela 30. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM2/2025 - vlerë minimale

Data:	Lloji i kontratave:	Operatori ekonomik:	Vlera:
10.04.2025	Rregullimi i dy automjeteve të rënda	Xhafer R. Musliu	965.00 €
20.05.2025	Furnizim me fatura për konsumatorë dhe fasiklla varëse	"Pika 5A" Sh.A.	990.00 €

Tabela 31. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM2/2025 - kuotim i çmimit

Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Vlera:
04.04.2025	Furnizim me reagjenta kimik	"Interlab" Sh.P.K.	7,430.00€
25.04.2025	Furnizimi dhe instalimi i kamerave të sigurisë në porto arka	"FATI SECURITY" Sh.P.K.	817.00€
26.06.2025	Servisimi dhe mbushja e aparateve të zjarrit si dhe blerje të reja	"Murat Abazi" B.I.	961.00 €

Tabela 32. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM2/2025 - procedurë e hapur - vlerë e mesme

Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Vlera:
25.04.2025	Kyçjet (e rrugëve apo shtëpive individuale përgjetë kolektorit fshati Livoç i Epërm - Livoç i Ulët - Kodra e Thatë, gjatësi 800m)	"Eng Bau" Sh.P.K.	32,476.00€
08.05.2025	Furnizim me kimikate dhe bombola të zbrazëta	"Seykos" Sh.P.K.	56,350.00€
18.06.2025	Ndërtimi dhe rehabilitimi i rezervuarave në Kamenicë	K.N.T.Sh. "Teuta - M" Sh.P.K.	120,021.85€

Tabela 33. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM2/2025 - "Aneks kontratë"

Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Vlera
02.04.2025	Shtimi i kapacitetit të ujit përmes restaurimit të rezervuarit, hapjes së puseve dhe ndërtimit të rrjetit në Berivojcë - Aneks Kontratë	Grup i Operatorëve Ekonomik "Cubic Group" Sh.P.K.; NNTABC Sh.P.K.	12,504.00€

7. DIVIZIONI PËR CILËSI TË UJIT

7.1. Cilësia e ujit

Raporti i tremujorit të dytë të vitit 2025 jep një pasqyrë të përmblendhur të cilësisë së ujit të pijshëm nëpër të gjitha zonat e KRU "Hidromorava" Sh.A.

Bazuar në rezultatet e analizave fiziko - kimike dhe mikrobiologjike të punura në laboratorin qendror të KRU "Hidromorava", në Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik në Gjiçan - QRSHP si dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike - IKSHPK, cilësia e ujit gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, ka qenë rreth 99% në përputhje me vlerat parametrike për ujin e pijshëm.

Duke u bazuar në Planin për Monitorim të Cilësisë së Ujit, në KRU "Hidromorava", monitorimi i cilësisë së ujit bëhet nëpërmjet dhjetë zonave të ndara sipas karakteristikave të ujit.

1. **Zona HM 01** - burimi "Guri i Hoxhës" dhe "Liqeni i Përlepnicës", kjo është zona më e madhe në KRU "Hidromorava";
2. **Zona HM 02** - burimet e ujit në "Pasjan", "Fabrika e Përpunimit të Ujit në Velekincë";
3. **Zona HM 03** - burimi "Baja";
4. **Zona HM 04** - zonat rurale (burimet e ujit në Malishevë, Zhegër, Doberqan, Llovçë dhe Bilinicë);
5. **Zona HM 05** - Letnica, Fabrika për Përpunimin e Ujit në Letnicë;
6. **Zona HM 06** - burimet e ujit në fshatin Pozharan;
7. **Zona HM 07** - burimet e ujit në Kamenicë, fshatin Karaçevë dhe Shipashnicë;
8. **Zona HM 08** - burimet e ujit në fshatin Topanicë dhe Koretin;
9. **Zona HM 09** - burimet e ujit në fshatin Makresh, Novoberdë;
10. **Zona HM 10** - burimet e ujit në Ranillug dhe fshatin Ropotovë.

Parametrat të cilat kontrollohen për ta vërtetuar cilësinë e ujit janë:

Parametrat fizik të cilët janë punuar janë: era, ngjyra, shija, përqeshmëria elektrike, turbullira fortësia e ujit.

➤ **Parametrat kimik të cilët janë punuar:** pH, klori residual, amoniaku, nitritet, nitratet, sulfatet, hekuri, mangani, kalciumi, magnezi, shpenzimi i KMnO₄, fosfatet, kloruret, alumini.

Parametrat mikrobiologjik të cilët janë punuar: numri i tërësishëm i baktereve koliforme në 100 ml, bakteret koliforme me prejardhje fekale në 100 ml, numri i tërësishëm i baktereve të gjalla në 1 ml në 37 gradë celsius, streptokoket me prejardhje fekale në 100ml.

Në baza tre mujore punohen edhe metalet e rënda, trehalometanet THM, si dhe karboni total organik TOC.

Në përgjithësi, cilësia e ujit në KRU "Hidromorava" Sh.A., gjatë muajve prill, maj dhe qershor i ka përmbushur standardet e kërkuara për ujë të pijes, ku në shumicën e mostrave kemi pasur përputhje të vlerave parametrike për ujë të pijes, përveç në disa raste të rralla që kemi pasur mospërputhje të vlerave parametrike për të cilat janë ndërmarrë masa të menjëhershme dhe konsumatorët janë informuar me kohë përmes mjeteve të informimit.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025 kemi pasur mospërputhje të vlerave parametrike në këto zona:

Muaji prill 2025

➤ Zona HM05 - Fabrika për Përpunimin e Ujit në Letnicë

Për shkak të reshjeve të dendura atmosferike, në Fabrikën për Përpunimin e Ujit në Letnicë është vërejtur një rritje e menjëhershme e turbullirës së ujit që rrjedh drejtpërdrejt nga lumi. Duke pasur parasysh që uji hyn në sistemin e trajtimit vetëm përmes një ajrimi të thjeshtë, pa kaluar më parë në ndonjë rezervuar sedimentues për qetësim dhe fundërrim, ai arrin në filtërat e trajtimit me nivele të larta të turbullirës, gjë që vështirëson procesin normal të filtrimit dhe ndikon në cilësinë fillestare të ujit për trajtim. Filtërat ekzistues nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm për të përpunuar në mënyrë efektive ujin me turbullirë kaq të lartë, në mënyrë që të arrihen standardet e plota të cilësisë. Si rrjedhojë, në këto raste – edhe pse nuk vërehen tejkalime të rënda të turbullirës që të jenë të dukshme me sy të lirë – për arsye sigurie rekomandojmë që uji të mos përdoret për pije gjatë periudhës së turbullirës së lartë.

Kjo situatë është e përkohshme dhe zakonisht zgjat deri në 24 orë, duke ndodhur vetëm gjatë periudhave me reshje intensive atmosferike.

➤ Zona HM09 - Stacioni i Pompimit, Makresh - Novobërdë

Stacioni i pompimit në Makresh furnizohet me ujëra nëntokësore. Megjithatë, për shkak të afërsisë së madhe me lumin dhe reshjeve intensive, në zonën përreth burimit ndodhin përmytje të përkohshme. Si pasojë, ujërat sipërfaqësorë depërtojnë në shtresat nëntokësore dhe ndikojnë në rritjen e turbullirës së ujit që hyn në rrjetin e furnizimit. Kjo situatë zakonisht zgjat nga 1 deri në 2 ditë, derisa reshjet të ndalen dhe gjendja të stabilizohet. Duke qenë se në këtë stacion nuk ka trajtim të ujit, në disa raste uji mund të mos i përmbushë plotësisht standardet për konsum të sigurt. Megjithatë turbullira nuk është gjithmonë e dukshme me sy të lirë dhe uji nuk paraqet rrezik të menjëhershëm, për arsye sigurie rekomandojmë konsumatorëve që gjatë kësaj periudhe të mos e përdorin ujin për pije deri në përmirësimin e situatës.

Shënim: Në të dy rastet, konsumatorët janë njoftuar përmes faqes zyrtare të Ndërmarrjes që uji të mos përdoret për pije deri në stabilizimin e plotë të parametrave të cilësisë.

Muaji maj 2025

➤ Zona HM04 - Stacioni i Pompimit, Bilinicë dhe

➤ Zona HM09 - Stacioni i Pompimit, Makresh

Në të dyja zonat, gjatë kontrollit rutinë, operatori ka vërejtur se pompa dozuese e klorit ishte ndërprerë përkohësisht. Pas identifikimit të problemit, është ndërhyrë menjëherë dhe sistemi është rivendur në funksion, duke rikthyer dozimin normal të klorit në ujë.

Muaji qershor 2025

➤ Zona HM04 - Stacioni i Pompimit, Zhegër

Në Stacionin e Pompimit në Zhegër është evidentuar një mospërputhje e vlerave parametrike në një mostër të ujit, përfshirë mungesën e klorit rezidual dhe prezencën e baktereve. Menjëherë pas identifikimit të mungesës së klorit, janë ndërmarrë

masat e nevojshme për stabilizimin e parametrave, dhe është vazhduar me dozimin e rregullt të klorit për të siguruar cilësinë e ujit të pijshëm.

➤ **Zona HM06 - Stacioni i Pompimit, Sadovinë**

Për shkak të uljes së nivelit të ujit në burim, janë shënuar herë pas here ngritje të turbullirës. Lidhur me këtë, konsumatorët janë njoftuar në kohë reale përmes faqes zyrtare të ndërmarjes, ndërkohë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për përmirësimin e situatës.

➤ **Zona HM07 dhe HM08 - Rajoni i Kamenicës**

Ky rajon karakterizohet natyrshëm me ujëra më të forta krahasuar me zonat e tjera të KRU "Hidromorava". Si pasojë e thatësisë dhe rënies së nivelit të ujit në dy burime, është shënuar një rritje e lehtë e fortësisë së ujit. Kjo rritje nuk paraqet ndonjë ndikim negativ në shëndetin e konsumatorëve, por situata po monitorohet vazhdimisht.

➤ **HM10 - Stacioni i Pompimit, Novobërdë**

Është evidentuar mungesë e klorit rezidual dhe prani e baktereve në ujë. Menjëherë pas konstatimit, janë ndërmarrë masa për stabilizimin e parametrave dhe është rifilluar procesi i dozimit të ujit me klor.

8. DIVIZIONI PËR PRODHIMIN, IMPIANTET E UJIT DHE STACIONET E POMPIMIT

8.1. Furnizimi me ujë

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, niveli i ujit në akumulacionin e Përlepnices ka qëndruar stabil rreth kuotës 28 m. Edhe burimet tjera ujore në rajon, si "Baja", "Guri i Hoxhës" dhe pusët në Velekincë, kanë shfaqur situatë të mirë, ndonëse është vërejtur një rënie e lehtë e kapacitetit të tyre.

Furnizimi me ujë të pijshëm gjatë kësaj periudhe ka qenë i qëndrueshëm dhe i kënaqshëm. Funksionimi i stacioneve të pompimit është zhvilluar me pak probleme, dhe defektet në rrjetin e ujësjellësit janë adresuar me efikasitet falë reagimit në kohë të ekipeve teknike. Përpjekjet janë përqendruar në ruajtjen e balancës ndërmjet prodhimit dhe konsumit, duke shmangur mbiprodhimin dhe duke mbrojtur infrastrukturën.

Sasia totale e ujit të prodhuar në këtë periudhë ishte 2,324,134 m³, ndërsa ajo e faturuar 1,070,538 m³, që përkon me një UPF prej 53.9%.

Megjithëse janë hasur disa probleme teknike në disa stacione të pompimit (si në Kopernicë, Topanicë, Bilinicë, Zhegër, Malësi të Kamenicës dhe Ropotovë), defektet janë eliminuar në kohë të shpejtë dhe pa ndikuar ndjeshëm në furnizim.

8.1.1. Pajisje teknike dhe procedura të tenderimit

Gjatë kësaj periudhe është zhvilluar procedura e tenderimit për riparimin e gjeneratorit elektrik në impiantin e Përlepnices, por tenderi është anuluar dy herë për shkak të mospërmbushjes së kriterëve nga ofertuesit. Procesi mbetet pezull, në pritje të vendimeve nga instancat më të larta.

Gjithashtu, është realizuar aktiviteti për furnizim me kartela SCADA dhe sondë për matjen e nivelit të ujit, por pajisjet e dorëzuara nuk kanë përmbushur specifikat teknike dhe janë kthyer për zëvendësim.

8.1.2. Mirëmbajtja e infrastrukturës

Është përfunduar instalimi i ndriçimit të ri në objektet e administratës dhe impiantit në Velekincë, duke zëvendësuar pajisjet e vjetra me ndriçues më efikasë. Po ashtu, janë realizuar aktivitete të rregullta të kositjes së barit dhe pastrimit të ambienteve përreth rezervuarëve dhe stacioneve të pompimit, me qëllim ruajtjen e higjienës dhe sigurisë teknike.

8.1.3. Implementimi i projektit FLOWS

Gjatë këtij tremujori kanë vazhduar punimet në kuadër të projektit FLOWS, përfshirë ndërhyrje në stacionin e pompimit "Baja" dhe instalimin e gypit me diametër Ø600. Deri më tani nuk janë evidentuar pengesa që do të ndikonin në vazhdimësinë e punimeve. Informacione të detajuara priten nga menaxheri i projektit.

8.2. Sasia e ujit të prodhuar, ujit të faturuar dhe humbjeve të ujit

Sasia e ujit të prodhuar dhe të faturuar, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025, sipas analizës së bërë nga koordinatori për UPF-në, është paraqitur në tabelën nr. 27.

Tabela 34. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM2/2025

Burimi	Prodhimi (m ³)	Faturimi për (m ³)	UPF (%)
FPU Përlepnice dhe Guri i Hoxhës	1,038,249	788,915	48.3
FPU Velekincë	343,098		
Baja*10	144,190		
Pasjan (komulative)	14,487	1,231	91.5
Malishevë e Ulët	15,569	3,251	79.1
Llovcë	845	755	8.3
Dobërçan*10	27,403	8,591	68.6
Zhegër*10	58,165	23,683	59.3
Bilinicë	1,888	779	58.7
FPU Letnicë - Viti	281,920	78,405	72.2
Trestenik	55,060	8,559	84.5
Pozharani	67,660	23,636	65.1
Ujësjiellësi Letnicë	6,800	1,634	76
Stacioni i pompimit 1, Kamenicë	46,150	76,365	48.1
Stacioni i pompimit 2, Kamenicë	31,745		
Stacioni i pompimit 3, Kamenicë	11,774		
Stacioni i pompimit 4, Kamenicë	34,138		
Stacioni i pompimit 5, Kamenicë	4,740		
Stacioni i pompimit 6, Kamenicë	18,532		
Topanicë	16,795	13,731	18.2

Kopernicë & Kolloleç	7,720	6,374	17.4
Koretin	26,626	10,900	59.1
Shipashnicë	28,580	6,141	78.5
Karaçevë	9,654	3,797	60.7
Ranillug	15,110	7,695	49.1
Ropotovë	3,116	3,362	-7.9
Boston, Qulkoc, Makresh	14,459	2,714	81.2
Koretisht& Pasjak	0	0	0
Prodhimi total m ³ /TM2/2025	2,324,134	1,070,538	53.9

Sipas tabelës së përpiluar, rezulton se gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025 është prodhuar ujë i pijshëm në sasi prej: 2,324,134 m³, është faturuar 1,070,538 m³ dhe UPF rezulton në 53.9 %.

8.3. Mirëmbajta e rrjetit të ujësllësit

Në përgjithësi në zonat e shërbimit gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, kemi pasur 387 intervenime të natyrave të ndryshme si rrjedhje/plasaritje të gypave në rrjet, dëmtim i valvulave etj.

Në Njësine Operative në Gjilan kanë qenë (233) intervenime, në Njësine Operative në Kamenicë (109) intervenime, në Njësine Operative në Viti (38) intervenime, në Komunën e Ranillugut (3) intervenime dhe në Komunën e Novobërdës (6) intervenime, ndërsa në Komunën e Parteshit nuk ka pasur intervenime në rrjetin e ujësllësit.

Tabela 35. Zona e shërbimit, numri dhe natyra e defekteve të ndodhura gjatë periudhës së TM2/2025

Zona e shërbimit	Numri i defekteve	Lagjet/rrugët/vendbanimet	Natyrat e defekteve
Gjilan	233	Rrugët: Rr. "Ali Hadri", Rr. "Pajazit Ahmeti" Rr. "Ramadan Salihu", Rr. "Mulla Idrizi", Rr. "Arben Ramadani", Rr. "Lidhja e Prizerenit", Rr. "Raiz Sadiku", Rr. "Hamdi Berisha", Rr. "Halim Orana", Rr. "7 shtatori", Rr. "Xhevati Ajvazi", Rr. "Adem Jashari", Rr. "Kumanoves", Rr. "Isa boletini", Rr. "Mark Gashi", Rr. "Xheladin Kurbaliu" Rr. "Dajti", Rr. "Murat Bresalci", Rr. "Fatos Limani", Rr. "Lekë Dukagjini", Rr. "Abdullah Tahiri", Rr. "Vëllezërit Frashëri", Rr. "Ismajl Ismajli", Rr. "Lotë Vaka", Rr. "Muharrem Kurteshi", Rr. "Murat Kryeziu", Rr. "Makfire Deda" Rr. "Fatmir Ibishi", Rr. "Nëna Terezë", Rr. "Edit Dürhan", Rr. "Mulla Idrizi", Rr. "Ramiz Černica", Rr. "Dardania 2", Rr. "Ismet Jashari", Rr. "Nekibe Kelmendi" Rr.	Rrjedhje në rrugë (116) dhe rrjedhje në puseta (117).

		Arben Ramadani, Rr. Ali Pashë Tepelena, Rr. Fadil Jakupi, Rr. Bajram Llovca, Rr. Vëllezërit Llozana, Rr. "Komandat Drini", Rr. "Lekë Dukagjini" Rr. "7 Shtatori", Rr. "Naser Azemi", Rr. "Zija Shemsu", Rr. "Mulla Idrizi", Rr. Abdullah Presheva, Rr. "Xheladin Kurbaliu". Fshatrat: Nasalë, Përlepnicë, Zhegër, Dobërçan, Kmetovc, Malishevë, Zhegër, Livoqi Ulët, Velekincë	
Novobërdë	4	Fshatrat: Tomancë, Tullar.	Rrjedhje në rrugë (3) dhe rrjedhje në puseta (1).
Ranillug	3	Ropotovë, Glogovc dhe Qulkovc	Rrjedhje në puseta (3).
Kamenicë	109	Rr. "Sakenderbeu", Rr. "Doruntina", Rr. "Adem Jashari", Rr. "Gjon Sereqi", Rr. "Avdulla Kastrati", Rr. "Zhuje Selmani", Rr. "Celula e UÇK" Rr. "Filati", Rr. "Çerqiz Topulli", Rr. "Dardana", Rr. "Sef Kosharja", Rr. "Hafiz Ali Korqa", Rr. "Rahim Beqiri", Rr. "Sahit Baliq", Rr. "Bajo Topulli", Rr. "Adem Jashari", Rr. "Oso Kuka", Rr. "Fehmi Keka", Rr. "Mihal Grameno", Rr. "Nexhmedin Kuqi", Rr. "Lot Vaku", Rr. "Ilir Konushevi", Rr. "Agush Isufi", Rr. "Mic Sokoli", Rr. "Ekzodi" Rr. "Filizat", Rr. "Aleksa Kostic", Rr. "Mulla Jakupi", Rr. "Komandant Gaca", Rr. "Vllaznim Bashkim", Rr. "Hasan Prishtina" Rr. "Dëshmorët e Kombit" Rr. "Shqiptaria". Fshatrat: Karaçevë e Poshtme, Kopernicë, Shipashnicë e Epërme, Koretin, Topanicë, Berivojcë,	Rrjedhje në rrugë (37), rrjedhje në pusetë të ujëmatësve (60), shqyje nga rrjeti (5), verifikime (1) dhe zhvendosje e ujëmatësit (6).
Viti	38	Vitia: Rr. "Brigada 173", Rr. "Agim Ramadani", Rr. "Hoxhë Jonuzi", Rr. "28 Nentori", Rr. "2 Korriku". Fshatrat: Sadovinë e Jerlive, Sadovinë e Çerkezve, Pozharan.	Rrjedhje në rrugë (21), defekte në puseta (17).
Totali:	387 ¹¹		

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, ndërprerje të ujit për shkak të defekteve në rrjetin e ujësjellësit ka pasur në lagjet/rrugët:

¹¹ Në këto shifra janë të përfshira vetëm defektet dhe jo ankesat. Tjërësimet për ujëmatës jo funksional, verifikimet dhe kërkesat e ndryshme.

Muaji prill 2025:

- Në Rrugën "15 Qershori" Gjilan, është ndaluar uji rreth tre orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rrugën "Haqif Tetova" Gjilan, është ndaluar uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rrugën "Vëllezërit Frashëri" Gjilan, është ndaluar uji rreth tre orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në fshatin Koretin, Rruga "Sylë Canaj" Gjilan, është ndaluar uji rreth një orë e gjysëm për shkak të defektit në gypin DN 5/4 mm PE;
- Në fshatin Kopernicë është ndaluar uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin DN 63 mm PE;
- Në fshatin Koretin është ndaluar uji rreth pesë orë për shkak të pastrimit/dezinfektimit të rrjetit dhe rezervuarit;
- Rrjedhjet e tjera në Nj.O, Kamenicë kanë qenë në diametër $\frac{3}{4}$ ose 1" dhe ato janë evituar në presion ose për një kohë të shkurtër është ndaluar uji;
- Ndërrerjet e ujit për shkak turbullirës në FPU - Letnicë, nga e cila furnizohet qyteti i Vitisë, Ramnishta, Drobeshi dhe Gërmova në kohëzgjatje më pak se një orë.

Muaji maj 2025:

- Në fshatin Vërbicë e Kmetocit është ndaluar uji rreth tetë orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Ndërrerje e ujit për shkak të turbullirës në FPU - Letnicë, nga e cila furnizohet qyteti i Vitisë, Ramnishta, Drobeshi dhe Gërmova me kohëzgjatje prej 12 orëve;
- Në fshatin Karaçevë e Poshtme, Rr. "Hevzi Karaçeva", është ndaluar uji rreth një orë e gjysëm për shkak të defektit në gypin DN 63mm PE;
- Në fshatin Karaçevë e Poshtme, Rr. "Mulla Destani", është ndaluar uji rreth një orë e gjysëm për shkak të defektit në gypin DN 63mm PE;
- Në Rr. "Tahir Sinani", Kamenicë, është ndaluar uji rreth një orë për shkak të defektit në gypin DN 5/4 mm PE;
- Në fshatin Koretin është ndaluar uji rreth një orë për shkak të defektit në gypin DN 6/4 mm PE;
- Në fshatin Karaçevë e Poshtme, konkretisht në rrugën kryesore është ndaluar uji rreth tre orë e gjysëm për shkak të defektit në gypin DN 90mm PE;
- Në fshatin Koretin është ndaluar uji rreth një orë për shkak të defektit në gypin DN 90 mm PE;
- Në fshatin Shipashnicë të Epërme, Rr. "Dodona", është ndaluar uji rreth një orë për shkak të defektit në gypin DN 5/4mm PE;
- Në fshatin Karaçevë e Poshtme, është ndaluar uji rreth tre orë për shkak të defektit në gypin DN 125mm PE;
- Në Rr. "Beteja e Kikës", është ndaluar uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin DN 125mm PE;
- Rrjedhjet e tjera kanë qenë në diametër $\frac{3}{4}$ ose 1", të cilat janë evituar në presion ose për një kohë të shkurtër është ndaluar uji.

Muaji qershor 2025:

- Në Fshatrat "Zhegër dhe Nasalë" është ndaluar uji rreth tetë orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rr. "Vëllezërit Frashëri" në Gjilan është ndaluar uji rreth katër orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rr. "Hamdi Kurteshi" në Gjilan është ndaluar uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rr. "Vllaznim Bashkim" në Kamenicë, është ndaluar uji rreth 1.5 orë për shkak të defektit në gypin DN 6/4 PE;
- Rrjedhjet e tjera në Nj. O. Kamenicë kanë qenë në diametër $\frac{3}{4}$ ose 1", janë evituar në presion ose për një kohë të shkurtër është ndaluar uji.

Shënim: Për shkak të natyrës së punës të evitimit të rrjedhjeve, shumica e defekteve janë evituar në shtypje pa e ndalë ujin fare, këto raste janë kur defektet janë në profil të gypit të vogël ose kur nuk është i dëmtuar gypi shumë.

8.3.1. DMA - zonat

Në zonën e shërbimit për regjionin e Gjiçanit i kemi (6) gjashtë zona DMA:

1. Lagjen Dardania 1 dhe 2¹²;
2. Livoç i Ulët;
3. Kufcë e Epërme;
4. Kmetovc dhe Verbicë e Kmetovcit;
5. Shillovë e Muhaxherëve¹³ dhe
6. Zona më e madhe është ajo ku përfshihen Lagjet e Zabelit, Arbërisë, Velekinca dhe Bregu i Djegun¹⁴.

Tabela 36. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë periudhës së TM2/2025 në DMA zonat për regjionin e Gjiçanit

	Burimi	Prodhimi (m ³)	Faturimi për (m ³)	UPF (%)
1.	Rr. "Lidhja e Prizrenit" *10	56,629	132,620	52.1
2.	Lagjja "Bregu i Djegun" (te ish kombinati i duhanit)	15,159		
3.	Rr. "Hysen Tërpeza"	6,595		
4.	Lipovicët	25,025		
5.	Mbrapa shkollës në Velekinçë DN 63	8,061		
6.	Velekinçë DN 90	63,275		
7.	Rr. "Mulla Idrizi"	97,295		
8.	Rr. "Esat Berisha" *10	4,678	2,050	45.72
9.	Shillova 1	1,033		
10.	Shillova 2	2,744	9,612	51.2
11.	Kmetovc	19,678		
12.	Kufcë e Epërme	5,564		
13.	Livoç i Ulët	34,378	16,113	63.1
14.	Lagjja "Dardania 1" *10	67,079	67,317	39.1
15.	Lagjja "Dardania 2" *10	43,437		
	Prodhimi total m ³ /vit:	450,630	233,259	48.2

¹² Përfshinë burimet 14 dhe 15 të paraqitura në tabelën 36.

¹³ Përfshinë burimet 9 dhe 10 të paraqitura në tabelën 36.

¹⁴ Përfshinë burimet nga 1 deri në 8 të paraqitura në tabelën 36.

Në zonën e shërbimit për regjionin e Kamenicës kemi një zonë DMA: Berivojcë – Lagjja Iliria.

Në zonën e shërbimit për regjionin e Vitisë i kemi dy zona DMA:

1. Pozhorani
2. DMA Zonë mbrenda qytetit të Vitisë.

8.4. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, në rrjetin e kanalizimit kanë qenë gjithsej: 394 intervenime duke përfshirë Njësitë Operative në Gjilan, Kamenicë dhe Viti.

Tabela 37. Numri i intervenimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së TM2/2025

Njësia	Numri i intervenimeve	Përshkrimi
Gjilan	320	Debllokime kanalizimi dhe pastrimi i pusetave
Viti	38	Debllokime kanalizimi dhe pastrim i pusetave
Novobërdë	6	Debllokime kanalizimi dhe pastrimi pusetave
Partesh	4	Debllokime kanalizimi dhe pastrimi pusetave
Kamenicë	24	Debllokime kanalizimi dhe pastrimi pusetave
Shkolla të mesme /Burgu	2	Debllokime kanalizimi dhe pastrimi pusetave
Total:	394	

Gjatë kësaj periudhe gjithashtu, në Nj.O. në Gjilan, kemi pasur (10) intervenime me autocisternë si dhe (13) vendosje të kapakëve në puseta të kanalizimeve.

Tabela 38. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit gjatë periudhës së TM2/2025 në Gjilan

Muaji	Gjatësia e rrjetit të kanalizimit (km)
Prill	9 km
Maj	14.27 km
Qershor	12.15 km
TOTALI	35.42 km

9. DIVIZIONI PËR PLANIFIKIM DHE MENAXHIM TË PROJEKTEVE

9.1. Aktivitetet e realizuara gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, Divizioni për Planifikimin dhe Menaxhimin e Projekteve ka realizuar aktivitetet e paraqitura në tabelën më poshtë:

Tabela 39. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë periudhës së TM2/2025

	Aktivitet	Numri i aktiviteteve
1.	Pëlqime në parim për banime kolektive dhe afarizëm	12
2.	Pëlqim në parim për banim individual	32
3.	Pëlqim në parim për institucione	4
4.	Evidentimi i intervenimeve në GIS	68
5.	Insertimin e kërkesave të reja për kycje në rrjetin e ujës-jellës	47
6.	Vlerësim të ofertave në Prokurim	5
7.	Menaxhim dhe mbikëqyerje të kontratave	5

Përveç aktiviteteve të zakonshme të planifikimit, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025, zyrtarët nga divizioni janë angazhuar intensivisht në tri projekte të rëndësishme strategjike për zhvillimin e Ndërmarrjes:

1. PROJEKTI FLOWS

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, punimet në terren nga Operatorët Ekonomikë kanë vazhduar me intensitet, ku janë realizuar ndërhyrje në disa segmente, përfshirë linjën 1A (fi 630mm), linjën 3B (fi 315mm), si dhe në stacionin e pompimit në Gjilan. Fillimisht, në këtë lokacion është bërë pastrimi dhe rrethimi i zonës, ndërsa më pas është nisur ndërtimi i stacionit të pompimit "Burgu".

Në muajin maj është siguruar pëlqimi nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) për lejimin e procedurës për marrjen e lejes ndërtimore për rezervuarin me sipërfaqe 945 m², ndonëse parcela është ende në proces të shpronësimit. Pas këtij pëlqimi, janë nisur procedurat për pajisje me leje ndërtimore, duke përfshirë aplikimin për kushte ndërtimore, për të cilat aktualisht jemi në pritje të vendimit përkatës.

Në muajin qershor, në kuadër të projektit, janë realizuar punime në rrugën "Avdullah Presheva" (Linja 2, Seksioni C), ku është bërë shtrirja e plotë e gypit. Gjatë të njëjtës periudhë, janë kryer gjithashtu punime në stacionet e pompimit "Baja" dhe "Burgu".

Në përfundim të muajit, kemi siguruar lejen ndërtimore të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Gjilanit, çka përbën

një hap të rëndësishëm drejt përmbylljes së fazave ndërtimore të projektit.

2. PROJEKTI ITUN

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2025, është pranuar raporti përfundimtar i mbikëqyrjes dhe janë mbajtur diskutime lidhur me finalizimin e raportit të ndërtimit. Komuna e Gjilanit është duke punuar në procedurat për shpronësimet/lejekalimet, dhe ka dorëzuar një zotim zyrtar se këto do të përfundojnë në fillim të vitit 2025.

Komisioni për vlerësimin e ofertave lidhur me tre tenderët:

1. Mbikëqyrja e punimeve,
2. Ndërtimi i ITUN, dhe
3. Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit,

ka dorëzuar vlerësimet teknike në BERZH, nga ku është marrë:

- Aprovim në parim për tenderin e ndërtimit të fazës së parë të ITUN, dhe
- Aprovim përfundimtar për tenderin e mbikëqyrjes dhe atë të rrjetit të kanalizimit.

Në takimin e fundit me BERZH, është arritur pajtueshmëri për të vazhduar me njoftimin e operatorëve ekonomikë fitues dhe për të filluar negociatat për lidhjen e kontratave. Gjatë muajit qershor, operatorët fitues për mbikëqyrje dhe ndërtimin e kolektorit kanë pranuar njoftimet për kontratë.

3. Projekte të tjera kapitale (konform PB 2025–2027)

- **Projekti: "Ndërtimi dhe rehabilitimi i rezervuareve në Kamenicë"**


Është përpiluar paramasa, parallogaria dhe dosja e tenderit.

- **Projekti: "Kycjet individuale në Fshatin Uglar"**

Është përgatitur paramasa, parallogaria dhe dosja e tenderit për tenderin.



U.D. Kryesues i Bordit të Drejtorëve
KRU "Hidromorava" Sh.A. Gjilan



z. Habil Zeqiri



**KRU
HIDROMORAVA**



Na kontakti

info@kru-hidromorava.com

Adresa:

Rr. Vëllezrit Gërvalla, Nr. 71,
Gjilan, Republika e Kosovës

 0800 61 000



<https://kru-hidromorava.com/>